



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 janar 2013  
Nr. Ref.:RK 356/13

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr.KI-15/12**

Parashtruesi

**Xhavit Gashi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Rev.I.Nr.314, të 10 janarit 2012**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Surøy, gjyqtar  
Almíro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa ishte paraqitur nga Xhavit Gashi, me vendbanim në Prishtinë.

### Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, Rev. I. Nr. 314/2009  
të 10 janarit 2012.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekti i çështjes ka të bëj me kërkesën e parashtruesit për të detyruar Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale që parashtruesin ta kthejë në punën tij të mëparshme, ose në detyra të punës që i përgjigjen përgatitjes profesionale, si dhe kompensimin e të ardhurave personale.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 21.4 dhe në nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

## **Procedurat në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 20 shkurt 2012, Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
6. Me vendimin e Kryetarit për caktimin e Gjyqtarit Raportues me Nr. GJR. KI 15/12 të datës 21 shkurt 2012, Gjyqtarja Gjyljeta Mushkolaj është caktuar Gjyqtare Raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit për caktimin e kolegjit shqyrtares me Nr. KSH. 15/12, është caktuar Kolegji Shqyrtares i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami.
7. Me Vendimin e Kryetarit për zëvendësimin e Gjyqtarit raportues me Nr. GJR. KI 15/12 të datës 2 korrik 2012, Gjyqtari Kadri Kryeziu është caktuar Gjyqtar Raportues. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit për zëvendësimin e gjyqtarit në kolegji shqyrtares me Nr. KSH. 15/12, është caktuar Kolegji Shqyrtares i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Më 10 dhjetor 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës lidhur me regjistrimin e kërkesës.

## **Përbledhja e fakteve**

9. Parashtruesi, sipas shkresave të bashkëngjitura në kërkesën e tij, ka qenë në marrëdhënie pune si vozitës në ish-Fondin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Punësuarve në Prishtinë, duke vazhduar marrëdhëni e punës deri me 1 tetor 2000.
10. Si rezultat i procesit të themelimit të Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/10), më 25 shator 2000 shpalen konkurse për pranimin e personelit. Pas aplikimit dhe zhvillimit të procedurave të konkursit, parashtruesi nuk pranohet në pozitën, për të cilën kishte konkurruar.
11. Më 24 mars 2003, parashtruesi i kërkesës ka ushtruar padi kundër Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kérkuar kthimin në punën e tij të mëparshme si “vozitës”, ose në tjetër punë apo detyra të punës që janë në përputhje me përgatitjen e tij profesionale, si dhe kompensimin e të ardhurave.
12. Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin e saj Cl. Nr. 85/2003 të 23 shtatorit 2004 refuzon kërkesëpadinë e parashtruesit, duke vlerësuar se as Departamenti Shëndetësisë dhe i Mirëqenies Sociale dhe as Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale nuk kanë vazhdimësinë dhe se nuk janë trashëgimtar të Fondit të atëhershëm për

Sigurimin Pensional dhe Invalidor dhe si rezultat i kësaj Ministria për Punë dhe Mirëqenje Sociale nuk mund të detyrohet për kthimin e parashtruesit në punë.

13. Parashtruesi i kërkesës ka ushtruar ankesë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin e saj AC. Nr. 415/05 të 19 shkurtit 2007 ka vlerësuar se “ *gjykata e shkallës së parë në gjendjen e vërtetuar faktike në mënyrë të drejtë ka aplikuar dispozitat materiale, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.*”
14. Parashtruesi i kërkesës po ashtu ka paraqitur revizion ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata Supreme me aktgjykimin e saj Rev. I. Nr. 314/2009 të datës 10 janar 2012 ka refuzuar si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës duke konsideruar [...]“ *si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instances më të ulët sipas të cilit është refuzuar kërkesëpadia e paditësit, pasi që nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar se as Departamenti i Administrativ i Punës dhe Punësimit të themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/24 si dhe Ministria për Punë dhe Mirëqenje Sociale, përfshirë si i paditur në këtë kontest nuk janë trashëgimtar të Fondit të atëhershëm për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Punësuarve të Kosovës, punëtor i së cilës ka qenë paditësi. Paditësi me të paditurin nuk ka themeluar marrëdhënie pune dhe se i padituri nuk ka detyrim ndaj paditësit dhe të njëjtit i mungon legitimiteti pasiv në procedurë.*”

#### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

15. Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se cili nen i Kushtetutës është shkelur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe gjykatave tjera të rregullta.
16. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesën që [...] “ *të vendosë në favor tim sepse ndaj meje Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka bërë padrejtësi duke më larguar nga puna pa kurrfarë mbështetje ligjore.*”
17. Parashtruesi nga Gjykata Kushtetuese po ashtu kërkon që të hidhen poshtë të gjitha aktgjykimet e lartcekura, sepse sipas parashtruesit të kërkesës në rastin e tij nuk është respektuar drejtësia.

#### **Pranueshmëria e kërkesës**

18. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës
19. Neni 48 i Ligjit Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Kosovës parashev:

*„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.“*
20. Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se cila e drejtë i është shkelur dhe cili nen i Kushtetutës mbështetë kërkesën e tij, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit
21. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, ku shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta, përvëç nëse dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së

drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para.28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

22. Parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis*, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmérinë e kërkesës, nr. 53363/99 të 31 majit 2005).
23. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e tij pranë gjykatave të rregullta. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta dhe arbitrarë (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmérinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
24. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36.2 (b) të Rregullores së punës që parasheh “*Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese*”.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 48 të Ligjit dhe në përputhshmëri me rregullin 36. 2 (b) të Rregullores, më 17 janar 2013, njëzëri

### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Kadri Kryeziu

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani